



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.268, datë 11.10.2022

**PËR  
“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KOMUNIKIMIN E KËSHILLIT TË  
LARTË TË PROKURORISË ME MEDIAN””**

Bazuar në nenin 189 pika 1, germa “c”, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin Nr.7756, datë 11.10.1993, “Për Shtypin” i ndryshuar, ligjin Nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin Nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”” i ndryshuar, ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, si dhe me propozimin e grupit të punës ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.132, datë 14.09.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Rregullores “Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Median”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 11.10.2022.

**KRYETAR**

**Alfred Balla**

